

AKTI I THEMELIMIT

I shoqerise tregtare me pergjegjesi të kufizuar: “ African ” Sh.p.k.

NENI 1

Ne Sarande sot me 27.03.2024 shtetasja e poshteshenuar, me vullnet te lire dhe te plote krijone shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar:

“ African ” Sh.p.k.

NENI 2

Selia Qendrore e shoqerise: “ African ” Sh.p.k. do te jete ne adresën: Vlore, Sarande, Lagjja Nr.4, Rruga Mitat Hoxha, Godine me nr. pasurie 26/432, Zk.8641

Dhe Adrese sekondare: Vlore, Sarande, Ksamil, Lagjja nr.2, Rruga Vace Zela, Godine 1-kateshe Nr.1

NENI 3

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte pa afat te percaktuar, duke filluar afati nga dita e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Me vendim të Asamblese se Ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim Q.K.B. per të bere shenimet e nevojshme.

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise tregtare: “ African ” Sh.p.k. do te jete:

Bar – Kafe, Stacion Plazhi

NENI 5

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100,000 leke (njqindmije) leke, formuar dhe nenshkruar nga 1 ortak ose 1 kuote .

- Ortaku themelues: ELISJA BABI: Zoteruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 (njqinde mije) Lekë që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortakët kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë mund të rritet ose zvogëlohet, mbi bazën e vendimit me shkrim që merr Asambleja e Ortakëve, i cili nënshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet në regjistrin përkatës. Në këto raste, vendimi merret nga ortakët që përfaqësojnë 100% të kuotave të kapitalit themeltar.

NENI 7

Ortakët duhet të bëjnë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajnë sekretin e saj dhe të mos të demtojnë interesat e personave të tjerë të shoqërisë.

NENI 8

Shoqëria cel llogari bankare në lekë dhe në çdo lloj valute të huaja, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

NENI 9

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- 1-Asambleja e Ortakëve
- 2-Administratori

Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve dhe Administratorit do të përcaktohen në statutin e shoqërisë tregtare “ **African** ” Sh.p.k.

NENI 10

Shoqëria do të drejtohet nga 1 Administrator për një afat 5 vjeçar:

Administratori do të jetë:

Znj. ELISJA BABI

NENI 11

Çdo mosmarrveshje apo konflikt që mund të lind gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë si rregull dhe përgjithësisht ortakët duhet ta zgjidhin me mirekuptim, në të kundërtën kompetentë për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.



NENI 12

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, vecanerisht me ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe shoqerite tregetare" (te ndyshuar).

NENI 13

Ky akt themelimi do te hyje ne fuqi pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

NENI 14

Akti i themelimit u perpilia ne 2 (dy) kopje dhe u nenshkrua rregullisht nga ortaku themelues.

Themeluesi i shoqerise

ELISJA BABI

